



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 8233 prot.

Kamëz, më 22.07.2024

RINOVIM KONTRATE QIRAJE

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë; Kontratës Fillestare nr. 6608 prot., datë 21.07.2022; Rinovimit të Kontratës së Qiras nr. 5609 prot., datë 21.07.2023.

Sot, më datë 22 . 7 .2024, palët kontraktore me vullnetin e tyre të lirë nënshkruan këtë rinovim kontrate, si më poshtë:

Bashkia Kamëz, përfaqësuar nga **Znj. Rebeka SULEJMANI** - Zv. Kryetar i Bashkisë Kamëz, me seli në adresën: Bulevardi “Nënë Tereza”, nr. 492.

dhe

Shoqëria “BANKA e TIRANËS” SHA, person juridik shqiptar me Vendimin Nr.12718 dt. 03.11.1995, dhe që vepron si BANKË me Licensën Nr. 07, datë 12.09.1996 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, me NIPT: J61924008V, me seli ne Rugën “Ibrahim Rugova” - Tiranë, përfaqësuar nga përfaqësueset e posaçme **Drejtuese e Divizionit të Rikuperimeve Bankare, Znj. Elona SEJKO (GJIPALI)**, e bija e _____, e datëlindje _____ lindur në Tiranë, banuese në adresën _____, Seksioni 2, Ap. 34, Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me N _____ (me Nr. Personal _____), madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe **Drejtore e Divizionit Operacional (COO) Znj. Eralda TAJAJ**, e bija e _____, e datëlindje _____, lindur në Tiranë, banuese në adresën _____ Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me _____ (me Nr. Personal _____)

, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në bazë të Prokurës së Posaçme me Nr. 236 Rep, e Nr. 130/2Kol, datë 30.01.2017, redaktuar nga notere Eriketa KOKOLI, lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, z. **Dritan MUSTAFA** (më tej referuar si “**QIRAMARRËSI**”).

NENI 1

Objekti

Objekti i kësaj kontrate është rinovimi i Kontratës Fillestare nr. 6608 prot., datë 21.07.2022, të rinovuar me kontratën nr. 5609 prot., datë 21.07.2023, me objekt: “*Dhënia me qira e një pjese të pasurisë me numër 92/30, e llojit truall me sipërfaqe 2.000 m² (dy mijë metra katrorë) dhe ndërtesë “Pallati i Kulturës Kamëz” me sipërfaqe 1.263 m² (një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre metra katrorë) e pasurisë shtetërore dhe më konkretisht: “Ambiente brenda Pallatit të Kulturës të llojit “Ndërtesë”, me sipërfaqe 165 m² (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë metra katror) në përgjegjësi administrimi të Bashkisë Kamëz, sipas genplanit dhe çertifikatës nr. 1864577, datë 04.03.2019, bashkëlidhur kontratës”.*

NENI 2

Afati i kontratës

Kontrata fillestare me nr. 6608 prot., datë 21.07.2022, e rinovuar me kontratën nr. 5609 prot., datë 21.07.2023, rinovohet për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data 19.07.2024 deri më datë 19.07.2025.

NENI 3

Vlera e kontratës

Vlera totale e qirasë e përcaktuar në kontratën fillestare nr. 6608 prot., datë 21.07.2022 nuk ndryshon me nënshkrimin e rinovimit të kontratës, pra “Qiramarrësi” detyrohet t’i paguajë “Qiradhënësit” detyrimin mujor të kontratës, për 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) m² (metra katrorë) në vlerën 530 (pesëqind e tridhjetë) lekë për m² (metër katrorë).



NENI 4

Pjesët integrale të kontratës

Pjesë integrale e kësaj kontrate do të jenë të gjitha përcaktimet e tjera të specifikuara në kontratën fillestare nr. 6608 prot., datë 21.07.2022 (Rinovimi i kontratës nr. 5609 prot., datë 21.07.2023 është pjesë e pandashme e kontratës fillestare);

Kjo kontratë u hartua në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje, të cilat u nënshkruan me vullnetin e plotë e të lirë të palëve.

PALËT KONTRAKTORE

QIRADHËNËSI

BASHKIA KAMËZ

KRYETARI

Rakip SULI

ME URDHËR DHE DELEGIM

Z. KRYETAR

Rehëka SULEJMANI



QIRAMARRËSI

"BANKA E TIRANËS" SH.A.

përfaqësuar me prokurë nga:

**Drejtuese e Divizionit të Rikuperimeve Bankare
dhe Drejtore e Divizionit Operacional (COO)**

Znj. Elona SEJKO (GJIPALI)

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Elona Sejko", written over a horizontal line.

Znj. Eralda TAF AJ

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Eralda Tafaj", written over a horizontal line. Below this signature is another handwritten mark or signature in blue ink.